

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-189/13**

**Prishtinë,  
23 prill 2014**

Në çështjen juridike të

**N.S**

***Pala ankuese***

kundër.

**M.V.S**

***Paraqitësi i kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë***

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Elka Filcheva- Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Dag Brathole dhe Erdogan Haxhibeqiri anëtare, në ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/147/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA16519), të datës 19 prill 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 23 prill 2014, mori këtë

**AKTGJYKIM**

- 1- Hidhet poshtë si e palejueshme ankesa e N.S kundër vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/147/2012 (lënda e regjistruar me numër KPA16519), të datës 19 prill 2012.**

**Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:**

1. Më 8 dhjetor 2006, M.V.S ka paraqitur një kërkesë në Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP) duke kërkuar ri-konfirmimin e të drejtës së tij pronësore dhe ri-posedimin mbi ngastrën 5300/3 prej 12 ari dhe 33 metra katror në vendin e quajtur Zatra, në tokat e Pejës. Prona ishte humbur si rrjedhojë e rrethanave që ndodhën në Kosovë gjatë periudhës 1998/1999. Ai ka paraqitur një kontratë të shitblerjes për pronat të datës 25 shtator 1955 dhe fletën poseduese nr. 3057 të datës 1 qershor 1961. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së i ka verifikuar pozitivisht këto dy dokumente. Sekretaria Ekzekutive ka vërtetuar *ex officio* se në planin e tanishëm kadastral, pronë mban numrin dhe sipërfaqen e njëjtë – ngastra 5300/3 prej 12 ari dhe 33 metra katror.
2. Kërkesa është trajtuar si e pakontestuar.
3. Më tej, KKPK-ja pranoi kërkesën si të bazuar dhe mori vendimin e kundërshtuar, *pra* KPCC/D/A/147/2012 (lënda e regjistruar me numrin KPA16519), të datës 19 prill 2012. KKPK-ja e ka njohur paraqitësin e kërkesës si pronar të pronave. Vendimi i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës më 23 nëntor 2012.
4. Më 2 gusht 2013, N.S ka paraqitur një ankesë kundër vendimit duke pohuar se vendimi ishte marrë vetëm në bazë të provave të paraqitura nga paraqitësi i kërkesës dhe se kjo shkel të drejtën materiale. Pala ankuese nuk ka marrë pjesë në procedurë, edhe pse me aktgjykimin e Gjykatës Komonale të Pejës (nr. 25/2007 të datës 22 tetor 2007) pala ankuese ka të drejtën mbi një sipërfaqe prej 1 ari dhe 44 metra katrorë të ngastrës 5300/3 (e cila në tërësi ka sipërfaqen prej 12 ari dhe 30 metra katror).
5. Ai ka paraqitur aktgjykimin e cekur dhe kopjen e planit kadastral.
6. Më pas u kuptua se përderisa ishte duke vazhduar procedura pranë KKPK-së ai në të njëjtën kohë ka paraqitur një kërkesë kundër M.V.S për një pjesë të pronës së njëjtë pranë Gjykatës Komonale në Pejë – më 16 janar 2007. Është e qartë se ai ka qenë në dijeni për kërkesën e M.V.S të paraqitur më herët pranë KKPK-së, por për ndonjë arsye kishte vendosur që mos ta informojë KKPK-në për interesimin e tij në ngastrën e kërkuar.
7. Sipas dispozitivit të aktgjykimit të cekur, Gjykata Komonale e Pejës ka konfirmuar se N.S është pronar i ngastrës 5300/3 me sipërfaqe prej 1 ari dhe 44 metra katror në bazë të kontratës së shitblerjes (data nuk dihet).
8. Sipas pjesës argumentuese të vendimit, N.S kishte paraqitur kërkesën e tij kundër M.V.S më 16 janar 2007, *d.m.th* pas hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë

- komerciale e ndryshuar me Ligjin 03/L-79 (në tekstin e mëtejme Ligji 03/L-79) dhe pasi M.V.S veçse e kishte paraqitur kërkesën e tij në AKP-së, që kishte ndodhur më 8 dhjetor 2006.
9. Vendimi shpjegon se në procedurë M.V.S është përfaqësuar nga një avokat i autorizuar. Vendimi po ashtu shpjegon se M.V.S në një datë të panjohur ia kishte shitur pronën një personi të quajtur H.A, i cili pastaj ia ka shitur atë N.S (përsëri data nuk dihet). Sipas vendimit, kontratat e shitblerjes ishin humbur gjatë konfliktit.
  10. Vendimi nuk shpjegon pse Gjykata ka shqyrtuar kërkesën e N.S kur ka pasur të dhëna të mjaftueshme se kontesti pronësor ndërlidhet me konfliktin e armatosur në Kosovë në periudhën 1998/1999.
  11. Më 31 tetor 2013, paraqitësi i kërkesës, tani pala përgjegjëse në ankesë, M.V.S paraqiti përgjigjen ndaj ankesës. Ai pohon se është pronar i ngastrës. Ai e ka blerë atë në vitin 1955, është në emrin e tij në kadastër, ai kurrë nuk e ka takuar H.A dhe çfarëdo prove e paraqitur nga N.S është e rrejshme. Dokumentet lidhur me ngastrën nuk janë shkatërruar asnjëherë. Si arkivat në kadastër po ashtu edhe gjykata në Pejë kanë qenë të paprekura.

### **Arsyetimi ligjor:**

### **Pranueshmëria e ankesës:**

12. Ankesa është e palejueshme.
13. Neni 10.2 i Ligjit 03/L-079 parasheh që çdo person, përveç paditësit, i cili pretendon se ka të drejtë në pronën e kontestuar do të bëhet palë në këtë procedurë, me kusht që personi i tillë ta informojë Sekretarinë Ekzekutive për qëllimin e tij që të marrë pjesë në procedurën administrative brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi për kërkesën.
14. Në rastin konkret, është e qartë se pala ankuese ka pasur mundësinë që të merr pjesë në procedurën pranë KKPK-së. Në vend se ta informojë KKPK-në se ai pretendon të drejta ligjore mbi ngastrën, ai kishte paraqitur një kërkesë paralele për pronën e njëjtë pranë Gjykatës Komunale në Pejë.
15. Nuk dihet se për çfarë arsye Gjykata Komunale e ka shqyrtuar këtë kërkesë, e cila nuk ka qenë nën juridiksionin e saj. Gjykata i referohet nenit 18 të Ligjit 03/L-79 i cili përjashton juridiksionin e gjykatave të rregullta për kërkesat sipas nenit 3.1 *po aty* kur procedura për atë kërkesë nuk ka filluar para datës së hyrjes në fuqi të këtij Ligji. Ligji 03/L-079 (më parë Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50) ka hyrë në fuqi më 16 tetor 2006. Pas kësaj, gjykatat e

- rregullta nuk kanë pasur juridiksion në kontestet pronësore që ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i armatosur i periudhës 1998/1999.
16. Megjithatë, këto çështje nuk janë relevante për procedurën aktuale sepse Gjykata Supreme e ka shpallur ankesën të papranueshme.
17. Në bazë të lartcekurave dhe në përputhje me nenin 12.2 të Ligjit 03/079 lidhur me nenet 196 dhe 186.3 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, Gjykata ka vendosur sikur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **Këshillë ligjore**

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX**

**Dag Brathole, Gjyqtar i EULEX-it**

**Erdogan Haxhibeqiri, Gjyqtar**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**